



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 3 Mars 2023

Nr: 90

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS TË BASHKISË KOLONJË, PËR  
RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES  
VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 3 Mars 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim çështjen administrative me:

**SUBJEKT:** Zj. Sofika Rexhepi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kolonjë

**OBJEKT:** Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Kolonjë, për raportimin e veprimtarive publike

**BAZA LIGJORE:** Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**K O N S T A T O J :**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 11.2.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka marrë indicie për organizimin e 1 (një) veprimtarie publike nga ana e bashkisë Kolonjë.

Indicia është marrë nëpërmjet provave ku pretendohet si në vijim:

Data: 3 Mars 2023

Nr: 90  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Kolonjë, për raportimin e veprimtarive publike”

*“Erseka, Leskoviku, fshatrat +50 familje në kalojnë në 100% ndriçim publik led me 0 fonde nga bashkia Kolonjë. Me super mbështetjen Fondi Shqiptar i Zhvillimit/ Albanian Development Fund të cilët siguruan të gjithë infrastrukturën e nevojshme, kemi filluar implementimin duke përmbushur kështu premtimin qysh në fillim të vitit 2023... dhe nuk mbaron këtu...”*

Link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=206160368592837&set=pcb.206160448592829>

*Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator”.*

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, pasi u shqyrtua paraprakisht çështja, u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Më datë 13.2.2023, bashkisë Kolonjë i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike.

Më datë 2.3.2023, bashkia Kolonjë bën me dije se: *“Në datë 28.1.2023, kryetari i bashkisë Kolonjë z. Erion Isai dhe Drejtori i Shërbimeve Publike z. Ermal Zylfo, kanë qenë prezent në një inspektim të punimeve për ndriçimin rrugor LED në unazën e qytetit Ersekë në orën 10:00. Prezent kanë qenë punonjësit e Drejtorisë së Shërbimeve Publike bashkë me mjetet për kryerjen e punimeve.”*

Nga verifikimi i provave dhe fakteve, vlerësohet se referuar nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, veprimtaritë e kryera nga kryetari i bashkisë Kolonjë nuk përbëjnë veprimtari publike dhe për rrjedhojë lidhur me këtë veprimtari nuk rëndon detyrimi për raportim në ndërfaqe. Evidentohet se kjo veprimtari përkon me përmbushjen e detyrave funksionale të kryetarit të bashkisë.

Në këto kushte, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, vlerësojmë se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të pushohet hetimi administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Kolonjë, nuk përbën shkelje të nenit 92, Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Data: 3 Mars 2023

Nr: 90  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Kolonjë, për raportimin e veprimtarive publike”

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

## V E N D O S:

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj zj. Sofika Rexhepi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në bashkinë Kolonjë.
2. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
3. Tërheqje vëmendje ndaj bashkisë Kolonjë, për marrjen e masave të menjëhershme, për raportimin e veprimtarive publike.
4. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**